

Titulli i thirrjes së hapur: Mbështetja e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në të gjithë Evropën për t'u përgatitur për kalimin drejt neutralitetit klimatik brenda qyteteve (Supporting national, regional and local authorities across Europe to prepare for the transition towards climate neutrality within cities) (HORIZON-MISS-2024-CIT-02-01)

Synimi i thirrjes është të mbështesë autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale në tranzicionin e qyteteve drejt neutralitetit të klimës.

Fokusi: Angazhimi i qyteteve evropiane në tranzicionin klimatik

Përshkrim i shkurtër i thirrjes:

Kjo thirrje për projekte synon të kontribuojë në zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në shtetet anëtare të BE-së dhe shteteve të asociuara me Programin Horizon Europe për të angazhuar qytetet evropiane në tranzicionin e neutralitetit klimatik. Thirrja synon të identifikojë sfidat dhe pengesat specifike të secilit vend në arritjen e neutralitetit klimatik, duke përfshirë strukturën ligjore, financimin, strukturat e qeverisjes dhe të promovojë praktikatat më të mira përmes shkëmbimit transnacional dhe ndarjes së përvojave. Për këtë qëllim, do të forcohen rrjetet kombëtare ekzistuese në shtetet anëtare dhe vendet e asociuara dhe do të inkurajohet krijimi i strukturave të tilla në vendet ku ato ende nuk janë themeluar. Këto rrjete do të funksionojnë si kontakte të qarta kombëtare për të mbështetur qytetet në përmbushjen e synimeve të tyre të lidhura me neutralitetin klimatik.

Përfituesit e Synuar të Grantit (po jo e limituar specifikisht tek këto institucione):

Çdo entitet i regjistruar në një shtet anëtar të BE-së ose të asociuar me Programin Horizon Europe.

Shuma e grantit:

Shuma totale e thirrjes është 3.000.000 euro dhe programi do të financojë të grante të barabarta ose më pak se kjo shumë.

Objektivat e thirrjes janë:

- Zhvillimi i kapaciteteve të autoriteteve
- Identifikimi i sfidave specifike për çdo vend
- Promovimi i praktikave më të mira
- Forcimi i rrjeteve kombëtare ekzistuese
- Krijimi i strukturave të reja në vendet që nuk i kanë

Aktivitetet e pranueshme

Aplikimet konsiderohen të pranueshme nëse përmbajtja e tyre korrespondon, tërësisht ose pjesërisht, me përshkrimin e temës.

Aktivitetet e mëposhtme janë përgjithësisht të pranueshme për grante nën Horizon Europe:

- Veprimet e kërkimit dhe inovacionit (RIA)
- Veprimet e Inovacionit (IA)
- Veprimet e Koordinimit dhe Mbështetjes (CSA)
- Veprimet e bashkëfinancimit të programit (CoFund) një program i tillë aktivitetesh mund të mbështesë: rrjetëzimin dhe koordinimin; kërkime; risi; veprime pilot; inovacioni dhe vendosja në treg; trajnimi dhe lëvizshmëria; ndërgjegjësimi dhe komunikimi; dhe shpërndarjen dhe shfrytëzimin.
- Veprimet e inovacionit dhe vendosjes së tregut (IMDA)
- Veprimet e trajnimit dhe lëvizshmërisë (TMA)
- Veprimet e prokurimit parakomercial (PCP)
- Prokurimi publik i veprimeve të zgjidhjeve inovative (PPI)

Kohëzgjatja e Zbatimit: 8 deri në 18 muaj

Afati i fundit për aplikim: 5 shtator 2024 në orën 17:00 (Ora e Brukselit).

Linku i thirrjes: <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/horizon-miss-2024-cit-02-01?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=relevance&keywords=MISS>